

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2) dhe nenit 30 paragrafi (1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në përbërje: Mr. Borçe Razmoski - kryetar, mr. Malinka Siljanovska Nikoliq, Aleksandar Trgačevski dhe Nikolla Trajčevski – anëtarë, duke vepruar në procedurën, e iniciuar sipas detyrës zyrtare, PK nr.09-26 të vitit 2019, kundër **Qytetit të Shkupit**, Bul. Ilinden nr.82, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe **Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup**, rr. Dame Gruev nr. 7/9-3, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, **i përfaqësuar nga Avokat Vlatko Despodovski Shkup**, rr. 1737 nr.24/11, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut për shkak të kundërvajtjes eventuale të kryer nga neni 7 paragrafi (1) pika 2), e në lidhje me nenin 59 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në seancën e mbajtur më 28.03.2025 solli këtë:

AKTVENDIM

Në procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare PK nr.09-6/1 të datës 21.01.2021 kundër Qytetit të Shkupit, Bul. Ilinden nr.82, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, rr. Dame Gruev nr. 7/9-3, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Avokat Vlatko Despodovski Shkup, rr. 1737 nr.24/11, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, për shkak të kundërvajtjes eventuale të kryer nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, **KVK konstatoi se Qyteti i Shkupit dhe Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup nuk kanë kryer kundërvajtje nga neni 7 paragrafi (1) pika 2), e në lidhje me nenin 59 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

A r s y e t i m

Deri te KVK nga ana e Avokates Anita Begova nga Shkupi është dorëzuar Kërkesë për ekzistimin e përqendrimit – kontratë monopoli e lidhur nr.09-26/1 të datës 09.10.2019, me të cilën e njofton Komisionin se ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup është lidhur Kontratë ekskluzive me të cilën Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup i është dhënë e drejta ekskluzive vetëm ata dhe askush tjetër të mos mund të jetë reklamues me reklama të vendosura në ndriçimin rrugor (shtylla/bandera) dhe atë falas.

Respektivisht, në Kërkesë theksohet se në pajtim me Kontratën reklamuesit i lejohet vendosja dhe mirëmbajtja e sistemit të shenjave për drejtimin e pjesëmarrësve në komunikacion në Shkup, prandaj konsiderohet se përfshihet:

- Përpilimi i standardeve dhe normativave për dukjen e shenjave dhe instalimeve dhe për modelet e vendosjes së tyre në korridorin e komunikacionit
- Përpilimi i hartave të lokacioneve për vendosjen e shenjave për udhëzim
- Përpilimi i shenjave dhe vendosja e tyre

- Mirëmbajtja në kohëzgjatje prej 15 vitesh llogaritur pas vendosjes së shenjës së fundit të planifikuar.

Më tej theksohet se vlera e Kontratës përcaktohet në shumë prej 10.000,00 euro në kundërvlerë të denarit, ndërsa nëse shkëputet Kontrata Qyteti i Shkupit t'i paguajë Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup dëmshpërblim në shumë prej 1.000.000,00 USD, ndërsa në të njëjtën theksohet se kohëzgjatja – mirëmbajtja e shenjave të planifikuara fillon nga momenti i vendosjes së shenjës së fundit e më pas në afat prej 15 vitesh.

Kontrata është lidhur më 21.01.2002 dhe me të njëjtën është përcaktuar se Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup ka detyrim të veprojë në afate të caktuara, respektivisht 90 ditë për Përpilimin e standardeve dhe normativave për dukjen e shenjave dhe instalimeve dhe për modelet e vendosjes së tyre në korridorin e komunikacionit, llogaritur nga dita e nënshkrimit të Kontratës dhe 60 ditë për Përpilimin e hartave të lokacioneve për vendosjen e shenjave për udhëzim llogaritur nga dita e miratimit të Standardeve dhe normativave nga ana e Këshillit të Qytetit të Shkupit. Në Shkresë theksohet se Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup deri më tani i ka shkelur të gjitha afatet, respektivisht nuk i kryen në tërësi detyrimet e veta, e gjithë kjo me qëllim që të mos fillojë llogaritja e afatit për realizimin e Kontratës. Nga ana tjetër, theksohet se kërkuesi nuk ka informacione nëse nga Qyteti i Shkupit është kërkuar veprimi në tërësi i detyrimeve sipas Kontratës.

Në seancën e mbajtur më datë 17.01.2020 KVK me Shkresën PK nr. 09-5/1 nga Qyteti i Shkupit kërkoi të deklarohet pas Shkresës nr.09-26/1 të datës 09.10.2019 dorëzuar Komisionit nga ana e Avokates Anita Begova, si dhe ta dorëzojë Kontratën e lidhur ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup.

Në seancën e mbajtur më datë 17.01.2020 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-5/2 e obligoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

Me Shkresën PK numër 09-5/3 të datës 29.01.2020, të dorëzuar përmes e-mail adresës, nga ana e Avokatit Vlatko Despodovski, si i autorizuar i Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, kërkoi vazhdimin e afatit për deklarim pas Konkluzionit PK nr. 09-5/2 të datës 17.01.2020.

Me Shkresën PK numër 09-5/4 të datës 30.01.2020, KVK e njoftoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup se afati për dorëzimin e të dhënave dhe dokumenteve të kërkuara me Konkluzionin nr. 09-5/2 të datës 17.01.2020 fillon të rrjedhë nga dita e pranimi të Shkresës me numër 09-5/4 të datës 30.01.2020.

Nga ana e Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup me Shkresën PK numër 09-5/5 të datës 30.01.2020 deri te KVK është dorëzuar Prokurë me të cilën Shoqëria e autorizon Vlatko Despodovskin, avokat nga Shkupi në emër dhe për llogari të Shoqërisë ta përfaqësojë para Komisionit në procedurë.

Me Shkresën numër 08-481/2 të datës 30.01.2020 (Yni PK numër 09-5/6 të datës 03.02.2020) Qyteti i Shkupit deri te KVK dorëzoi Përgjigje pas Shkresës PK nr. 09-5/1 të datës 17.01.2020.

Në Shkresë, Qyteti i Shkupit thekson se, në cilësinë e Porositësit, me Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, në cilësinë e Ekzekutuesit, ka lidhur Kontratë për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të shenjave për udhëzimin e pjesëmarrësve në komunikacion në Shkup nr. 08-116/1 të datës 21.01.2002. Qyteti i Shkupit lidhur me pretendimet se Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup i është dhënë e drejta ekskluzive vetëm ata dhe askush tjetër të mos mund të jetë reklamues me reklama të vendosura në ndriçimin rrugor (shtylla/bandera) dhe atë falas udhëzon në nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 të Kontratës, ku është përcaktuar se Porositësi ia kalon të drejtën ekskluzive Ekzekutuesit që instalimet e sistemit të shenjave dhe të shtyllave ndriçuese t'i shfrytëzojë për udhëzim komercial dhe reklamim. Lidhur me pretendimet se ka ndodhur shkelje e afateve, Qyteti i Shkupit thekson se në nenin 1 paragrafi 2 alinea 4 është përcaktuar se mirëmbajtja është në kohëzgjatje prej 15 vitesh llogaritur pas vendosjes së shenjës së fundit të planifikuar, ndërsa me këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për shkelje të afatit për arsye se në Kontratë është përcaktuar se në kornizat e realizimit të kompetencave të Qytetit të Shkupit është ndërtimi i vazhdueshëm i bulevardëve të reja dhe vendosja e shtyllave (banderave), prandaj në pajtim me dispozitat e Kontratës afati prej 15 vitesh as që ka filluar të rrjedhë.

Qyteti i Shkupit gjithashtu thekson se vlera e Kontratës përcaktohet në shumë prej 10.000 euro, ndërsa për shkak të mosveprimit, respektivisht mosrespektimit të dispozitave të Kontratës Ekzekutuesi ka të drejtë në 1.000.000 dollarë si dëmshpërblim për shkak të shkëputjes së Kontratës dhe dëmshpërblim për investimin e bërë, shpenzimet e pësuar, fitimin e humbur, si dhe kompensim të dëmit jo-material.

Me Shkresën PK numër 09-5/7 të datës 14.02.2020 Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, përmes Avokatit Vlatko Despodovski nga Shkupi dorëzoi Deklarim pas kërkesës – Fletëparaqitje për ekzistimin e përqendrimit pas Konkluzionit nr. 09-5/2 të datës 17.01.2020.

Në të njëjtën, Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, thekson se me Kontratën e lidhur me Qytetin e Shkupit nuk fiksohen çmime, sepse Kontrata nuk përmban dispozita për çmimet e shërbimeve dhe ato përcaktohen lirisht në treg. Gjithashtu, në Shkresë theksohet se Kontrata nuk e kufizon, e as nuk e ndan tregun, por bëhet fjalë për shërbime nga fusha e marketingut, ose më konkretisht outdoor marketingut, në të cilin shërbime të llojit lëndor për momentin ofrojnë një numër i madh i shoqërive, ndërsa një numër i madh i tyre kanë edhe koncesione nga Qyteti i Shkupit për vendosjen e llojeve të ndryshme të pajisjeve urbane.

Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup thekson se në pajtim me Kontratën e lidhur me Qytetin e Shkupit ka vëllim shumë më të madh të detyrimeve nga koncesionerët e tjerë në territorin e Qytetit të Shkupit, respektivisht për çdo shenjë orientimi komerciale të vendosur në territorin e Qytetit të Shkupit Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, është e detyruar të paguajë taksë komunale, e cila në nivel vjetor arrin mesatarisht mbi 2.000.000 denarë.

Më tej, Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, thekson se nuk ka të drejtë ekskluzive për vendosjen e shenjave të orientimit në rrugët dytësore. Respektivisht, njëra nga kompetencat ligjore të Qytetit të Shkupit dhe njërive të tjera të vetëqeverisjes lokale gjatë kujdesit për udhëzimin e pjesëmarrësve në komunikacion është ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore të komunikacionit, si dhe vendosja, zëvendësimi, mënjanimi dhe mirëmbajtja e shenjave të komunikacionit dhe pajisjeve mbrojtëse

në rrugët lokale dhe rrugicat. Në vitin 2002 Qyteti i Shkupit për ta realizuar këtë kompetencë ligjore ka lidhur Kontratë me Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, me të cilën ia ka bartur kompetencën këtij subjekti juridik.

Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup më tej thekson se në pajtim me Ligjin për rrugët publike secili mund të vendosë mbishkrim (shënim/panel/shenjë orientimi/tabelë reklamuese), prandaj në pajtim me Ligjin për rrugët publike Qyteti i Shkupit ka sjellë Vendim për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për vendosjen e mbishkrimeve dhe tabelave reklamuese në brezin mbrojtës të rrugëve publike në Qytetin e Shkupit dhe një numër i madh i subjekteve e shfrytëzojnë këtë të drejtë, respektivisht vendosin mbishkrime/shenja orientimi/shënime etj. të shumta.

Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup thekson se nuk mund të bëhet fjalë për ekskluzivitet që të vendosë mbishkrime/shenja orientimi/shënime, por këtë e bën në lokacione të përcaktuara paraprakisht nga ana e Qytetit të Shkupit.

KVK deri te Qyteti i Shkupit me Shkresën PK numër 09-5/8 të datës 06.11.2020 dorëzoi Ftesë për mbajtjen e takimit të punës, megjithatë në takimin e punës nuk mori pjesë përfaqësues nga Qyteti i Shkupit, dhe as nuk u dorëzua ndonjë përgjigje pas Ftesës së theksuar.

Në seancën e mbajtur më datë 06.11.2020 KVK Me Konkluzionin PK numër 09-5/9 e obligoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente, dhe atë:

- Sqarim dhe theksim të shërbimeve që i ofron Shoqëria për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup, respektivisht sqarim nëse krahas shenjave të orientimit të cilat i vendos në bazë të Kontratës me Qytetin e Shkupit, vendos edhe shenja orientimi dhe reklama me kërkesë të ndërmarrjeve për kompensim përkatës dhe
- Lokacion dhe sqarim të shenjave të orientimit të cilat Shoqëria për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup i vendos në territorin e Qytetit të Shkupit dhe
- Sqarim kush e paguan energjinë elektrike të përdorur për furnizimin e shtyllave për nevojat e shenjave të vendosura.

Me Shkresën PK numër 09-5/10 të datës 19.11.2020 Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup deri te KVK dorëzoi Përgjigje pas Shkresës PK nr. 09-5/9 të datës 06.11.2020.

Në Shkresë, lidhur me pyetjen "Sqarim dhe theksim të shërbimeve që i ofron Shoqëria për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup, respektivisht sqarim nëse krahas shenjave të orientimit të cilat i vendos në bazë të Kontratës me Qytetin e Shkupit, vendos edhe shenja orientimi dhe reklama me kërkesë të ndërmarrjeve për kompensim përkatës", theksohet se në pajtim me nenin 3 të Kontratës së lidhur me Qytetin e Shkupit, Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup kryen vendosjen e shenjave të

orientimit për udhëzim komercial dhe reklamim për nevojat e klientëve – shoqërive tregtare, si kompensim për shpenzimet për normimin, planifikimin, dizajnimin e sistemit të shenjave, shpenzimet për instalimet (përpunimi i shtyllave), blerjen e shënimeve për nevojat e Qytetit të Shkupit, vendosjen e tyre, sigurimin dhe mirëmbajtjen, të cilat shpenzime i paguan Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup. Krahas të gjitha shpenzimeve të theksuara, për çdo shenjë orientimi të vendosur ka detyrim të paguajë taksë komunale ndaj Qytetit të Shkupit, në pajtim me Vendimin e Qytetit të Shkupit nr. 08-2084/1 të datës 20.07.2005.

Lidhur me pyetjen "Lokacion dhe sqarim të shenjave të orientimit të cilat Shoqëria për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup i vendos në territorin e Qytetit të Shkupit", Shoqëria për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup në Shkresë thekson se të gjitha lokacionet në të cilat ka të drejtë të vendosë shënime për udhëzim dhe njoftim për nevojat e Qytetit të Shkupit dhe shënime për udhëzim komercial dhe reklamim janë përcaktuar me Vendimin nr. 18-317/2 të datës 07.07.2005 të Qytetit të Shkupit.

Me Shkresën PK numër 09-5/10 të datës 19.11.2020 Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup në shtojcë dorëzoi KVKje të Vendimit për shfrytëzimin e vendit për reklamim (në tekstin e mëtejme: Vendimi) të lëshuar nga Qyteti i Shkupit, Komiteti i Qytetit për Urbanizëm, Punë Komunale Banesore, Komunikacion dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor numër 18-317/2 të datës 07.07.2005 (vërtetuar nën numrin 0301-10 të datës 15.09.2005 në Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup).

KVK nga ueb faqja e Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup siguroi të dhëna lidhur me Ofertën për reklamim të jashtëm me PANELE LËVIZËSE.

Në seancën e mbajtur më datë 21.01.2021, KVK duke vepruar sipas detyrës zyrtare me Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-6/1 inicioi procedurë kundërvajtëse kundër Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, për arsye se kanë lidhur kontratë ekskluzive, me të cilën Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup i është dhënë e drejta ekskluzive që instalimet e sistemit të shenjave dhe shtyllave ndriçuese t'i shfrytëzojë për udhëzim komercial dhe reklamim, qëllimi dhe pasoja e së cilës është çrregullimi i konkurrencës në tregun për reklamim në shtyllat për ndriçim rrugor (reklamimi në panele ndriçuese/shenja orientimi të vendosura në shtylla për ndriçim rrugor për udhëzim komercial dhe reklamim), që paraqet kundërvajtje eventuale nga neni 59 paragrafi (1) pika 1), e në lidhje me nenin 7 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Me Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, KVK e obligoi Qytetin e Shkupit t'i dorëzojë të dhënat në vijim:

- Sqarim të detajuar të nenit 3 të Kontratës së lidhur ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup dhe
- A ka dhënë Qyteti i Shkupit vendim/miratim për shfrytëzimin e vendeve për reklamim në shtyllat e ndriçimit rrugor ndonjë personi tjetër juridik/shoqërie tregtare, përveç Shoqërisë për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup, nëse po, të dorëzohet KVKje nga akti me të cilin e njëjta është miratuar.

- Sqarim nëse në pjesën e banuar të Qytetit të Shkupit ka rrugë të cilat konsiderohen si rrugë shtetërore dhe në të cilat në pajtim me nenin 41 të Ligjit për rrugët publike është dhënë miratim për vendosjen e mbishkrimeve, objekteve reklamuese dhe tabelave reklamuese. Nëse po, të dorëzohet e dhëna se sa miratime të tilla janë lëshuar, e cilat janë ende në fuqi dhe në cilat rrugë/rrugica që gjenden në territorin e Qytetit të Shkupit.
- Sqarim të procedurës për dhënien e miratimit për vendosjen e objekteve reklamuese në brezin rrugor dhe mbrojtës të rrugës publike në territorin e Qytetit të Shkupit (e të cilat miratime lëshohen në pajtim me nenin 45 të Ligjit për rrugët publike). Më saktë sqarim kush mund të kërkojë, cila është procedura, sa kohë zgjat e njëjta, çfarë kompensimi i paguhet Qytetit të Shkupit, për çfarë afati lëshohet miratimi, nga çka varet miratimi/mosmiratimi i kërkesës dhe a miratohen kërkesa të tilla për lokacione që gjenden në rrugë të njëjta në Qytetin e Shkupit në të cilat Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup ka të drejtë ekskluzive që instalimet e sistemit të shenjave dhe shtyllave ndriçuese t'i shfrytëzojë për udhëzim komercial dhe reklamim.
- Sqarim të pikës 2. (dy) të Vendimit për shfrytëzimin e vendit për reklamim numër 18-317/2 të datës 07.07.2005 të lëshuar nga Qyteti i Shkupit lidhur me numrin prej 3939 vendesh për shënime për udhëzim dhe njoftim për nevojat e Qytetit të Shkupit a ka të bëjë ky numër me vende të cilat strikt Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup ka leje t'i shfrytëzojë apo ky është numri i përgjithshëm i vendeve për shënime për udhëzim dhe njoftim për nevojat e Qytetit të Shkupit, të cilat mund t'i shfrytëzojnë edhe ndërmarrje të tjera.
- Statutin
- Bilancin e suksesit për vitin 2019
- Ekstrakt nga Regjistri Qendror

Me Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, KVK e obligoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup t'i dorëzojë të dhënat në vijim:

- KVKje nga ofertat komerciale të shërbimeve të cilat Shoqëria për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup ua ofron klientëve të vet - shoqërive tregtare në vitin 2019 dhe 2020
- XXX¹
- Të hyrat e realizuara gjithsej nga ofrimi i shërbimit të reklamimit në shtylla të ndriçimit rrugor (qiraja e paneleve ndriçuese/shenjave orientuese të vendosura në shtylla për ndriçim rrugor për udhëzim komercial dhe reklamim) në vitin 2019 dhe
- Bilancin e suksesit për vitin 2019

Me Shkresën PK numër 09-6/2 të datës 28.01.2021 Shoqëria për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup kërkoi të vazhdohet afati për dorëzimin e të dhënave të kërkuara, të kërkuara me Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-6/1 të datës 21.01.2021.

Me Shkresën PK numër 09-6/3 të datës 29.01.2021, të dorëzuar përmes e-mail adresës, nga ana e Avokatit Vlatko Despodovski, si i autorizuar i Shoqërisë për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup, dorëzoi Plotësim të njoftimit të datës 28.01.2021.

¹ Të dhënat paraqesin sekret afarist

Me Shkresën PK numër 09-6/4 KVK më datë 02.02.2021 Shoqërisë për tregti dhe shërbime Produkcija Perspektiva SHPKNJP Shkup ia vazhdoi afatin për dorëzimin e të dhënave për 15 ditë shtesë.

Qyteti i Shkupit, me Shkresën numër 08-599/2 të datës 01.02.2021 (Yni PK numër 09-6/5 të datës 03.02.2021) dorëzoi përgjigje për të dhënat e kërkuara me Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK numër 09-6/1 të datës 21.01.2021.

Me Shkresën PK nr. 09-6/6 të datës 04.02.2021 Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup dorëzoi Kërkesë për këqyrje dhe fotoKVKjim të shkresave, ndërsa në shtojcë edhe Fletëpagesë në shumë prej 600,00 denarë për këqyrje dhe fotoKVKjim të shkresave.

Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup me Shkresën PK nr. 09-6/7 të datës 04.02.2021 deri te KVK parashtroi Kërkesë për sqarimin e Konkluzionit PK nr. 09-6/1 të datës 22.01.2021. Në të njëjtën kërkojnë sqarim lidhur me atë XXX.

Me Shkresën PK nr. 09-6/8 të datës 08.02.2021 KVK e njoftoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup se lidhur me Kërkesën e parashtruar për këqyrje dhe fotoKVKjim të shkresave, në pajtim me nenin 56, paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, këqyrja në shkresat në procedurë para Komisionit për vendimmarrje për kundërvajtje kryhet pas pranimit të njoftimit paraprak nga neni 42 paragrafi (1) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Me Shkresën PK nr. 09-6/9 të datës 08.02.2021 KVK deri te Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup dorëzoi Përgjigje ndaj Kërkesës për sqarimin e Konkluzionit PK nr. 09-6/1 të datës 22.01.2021. Në Shkresë KVK theksoi se me Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-6/1 të datës 22.01.2021 në pikën 2, alinea 2) shprehimisht theksohet të dorëzohen të dhëna - XXX.

Me Shkresën PK nr. 09-6/10 të datës 15.02.2021 Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup deri te KVK i dorëzoi provat e kërkuara, të kërkuara me Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-6/1 të datës 22.01.2021.

Me të dhënat e dorëzuara, Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup thekson se 10 klientët më të mëdhenj, të cilët kanë shfrytëzuar shërbim të reklamimit në shtyllat për ndriçim rrugor në vitin 2019 dhe gjysmën e parë të vitit 2020 janë si vijon: Shoqëria financiare për lëshimin dhe administrimin e kartelave kreditore Diners Club International MAK SHPKNJP Shkup, HALK BANKA SHA Shkup, Shoqëria për tregti dhe shërbime IBU Menaxhment SHPKNJP Shkup, Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë KAM SHPK Shkup, Shoqëria për tregti dhe shërbime KAN INTERNATIONAL SHPKNJP Shkup, MAKPETROL Shoqëri aksionare për qarkullim me naftë dhe derivate të naftës Shkup, Shoqëria për turizëm, hoteleri dhe shërbime MASTERBET SHPKNJP Shkup, Shoqëria për shërbime turistike dhe akomodim STONEBRIDGE – HOTEL SHPK Shkup, TRIGLAV SIGURIMI SHA Shkup dhe Shoqëria për sigurim UNIQA SH.A. Shkup.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/11 e obligoi Qytetin e Shkupit të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

- "KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/11.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/12 të datës 15.03.2021 KVK e obligoi Shoqërinë tregtare për përfaqësim, shërbime dhe tregti me shumicë dhe pakicë AKCENT MEDIA Agjencia nacionale reklamuese p.k. SHPKNJP import-eksport Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/12.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/13 e obligoi Shoqërinë për reklamë, marketing tregti dhe shërbime LEAD COMMUNICATIONS SHPK Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/13.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/14 e obligoi Shoqërinë për prodhim, tregti, marketing, propagandë dhe shërbime Screen Media eksport – import Zhelinë të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/14.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/15 e obligoi Shoqërinë financiare për lëshimin dhe administrimin e kartelave kreditore Diners Club International MAK SHPKNJP Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/15.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/16 e obligoi HALK BANKA SHA Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/16.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/17 e obligoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime IBU Menaxhment SHPKNJP Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/17.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/18 e obligoi Shoqërinë për tregti me shumicë dhe pakicë KAM SHPK Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/18.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/19 e obligoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime KAN INTERNATIONAL SHPKNJP Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/19.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/20 e obligoi MAKPETROL Shoqëri aksionare për qarkullim me naftë dhe derivate të naftës Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/20.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/21 e obligoi Shoqërinë për turizëm, hoteleri dhe shërbime MASTERBET SHPKNJP Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/21.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/22 e obligoi Shoqërinë për shërbime turistike dhe akomodim STONEBRIDGE – HOTEL SHPK Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/22.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/23 e obligoi TRIGLAV SIGURIMI SHA Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/23.

Në seancën e mbajtur më datë 15.03.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/24 të datës 15.03.2021 KVK e obligoi Shoqërinë për sigurim UNIQA SH.A. Shkup të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me Shkresën PK nr. 09-6/25 të datës 16.03.2021 dorëzoi letër shoqëruese të Konkluzionit për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve PK nr. 09-6/24. Me Shkresën nr. 0306/5997 të datës 19.03.2021 (Yni PK numër 09-6/26 të datës 19.03.2021) Shoqëria për sigurim UNIQA SH.A. Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/24 të datës 15.03.2021. (version konfidencial).

Me Shkresën nr. 0306/5998 të datës 19.03.2021 (Yni PK numër 09-6/27 të datës 19.03.2021) Shoqëria për sigurim UNIQA SH.A. Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/24 të datës 15.03.2021. (version jo konfidencial).

Me Shkresën nr. 0302/50-13 të datës 18.03.2021 (Yni PK numër 09-6/28 të datës 23.03.2021) Shoqëria për prodhim, tregti, marketing, propagandë dhe shërbime Screen Media eksport – import Zhelinë deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin nr. PK 09-6/14 të datës 15.03.2021.

Me Shkresën nr. 0302/1599 të datës 19.03.2021 (Yni PK numër 09-6/29 të datës 23.03.2021) MAKPETROL Shoqëri aksionare për qarkullim me naftë dhe derivate të naftës Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/20 të datës 15.03.2021.

Me Shkresën nr. 0302/159-17 të datës 17.03.2021 (Yni PK numër 09-6/30 të datës 23.03.2021) Shoqëria tregtare për përfaqësim, shërbime dhe tregti me shumicë dhe pakicë AKCENT MEDIA Agjencia nacionale reklamuese p.k. SHPKNJP import-eksport Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/12 të datës 15.03.2021.

Me Shkresën nr. 02/3149 të datës 23.03.2021 (Yni PK numër 09-6/31 të datës 23.03.2021) TRIGLAV SIGURIMI SHA Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/23 të datës 15.03.2021.

Me Shkresën nr. 01-841/1 të datës 23.03.2021 (Yni PK numër 09-6/32 të datës 24.03.2021) Shoqëria financiare për lëshimin dhe administrimin e kartelave kreditore Diners Club International MAK SHPKNJP Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/15 të datës 15.03.2021.

Me Shkresën PK numër 09-6/33 të datës 24.03.2021 Shoqëria për tregti dhe shërbime KAN INTERNATIONAL SHPKNJP Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/19 të datës 15.03.2021.

Me Shkresën nr. 0204-135 të datës 24.03.2021 (Yni PK numër 09-6/34 të datës 24.03.2021) Shoqëria për shërbime turistike dhe akomodim STONEBRIDGE – HOTEL SHPK Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/22 të datës 15.03.2021.

Me Shkresën nr. 245-02 të datës 22.03.2021 (Yni PK numër 09-6/35 të datës 26.03.2021) Shoqëria për turizëm, hoteleri dhe shërbime MASTERBET SHPKNJP Shkup deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/21 të datës 15.03.2021.

Me Shkresën nr. 13-2374/2 të datës 23.03.2021 (Yni PK numër 09-6/36 të datës 26.03.2021) Qyteti i Shkupit deri te KVK dorëzoi të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/11 të datës 15.03.2021.

Në Shkresë, Qyteti i Shkupit thekson se në territorin e Qytetit të Shkupit ushtrojnë veprimtari katër subjekte, të cilat kanë leje për vendosjen e billbordeve dhe atë:

1. Shoqëria për reklamë, marketing tregti dhe shërbime LEAD COMMUNICATIONS SHPK Shkup
2. Shoqëria për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup

3. Shoqëria për prodhim, tregti, marketing, propagandë dhe shërbime Screen Media eksport – import Zhelinë dhe
4. Shoqëria tregtare për përfaqësim, shërbime dhe tregti me shumicë dhe pakicë AKCENT MEDIA Agjencia nacionale reklamuese p.k. SHPKNJP import-eksport Shkup

Gjithashtu, në Shkresën e dorëzuar nga Qyteti i Shkupit theksohet se në pajtim me "Programin për ndryshimin dhe plotësimin e programit për vendosjen e pajisjeve urbane – pano reklamuese në rajonin e Qytetit të Shkupit për periudhën 2012 – 2027" numri i përgjithshëm i billbordeve të vendosura në territorin e Qytetit të Shkupit arrin 560, respektivisht: 0 bilborde në Zona 1, 62 bilborde në Zona 2, 429 bilborde në Zona 3 dhe 69 bilborde në Zona 4, të cilat janë të ndara ndërmjet katër shfrytëzuesve.

Me shkresën nr. 0204-135 të datës 24.03.2021 (Numri ynë PK 09-6/37 i datës 29.03.2021) Shoqëria për shërbime turistike dhe akomodim STONEBRIDGE – HOTEL SHPK Shkup dorëzoi në KVK përgjigje ndaj Konkluzionit numër 09-6/22 të datës 15.03.2021.

Me shkresën nr. PK 09-6/38 të datës 26.03.2021 Shoqëria për reklamim, marketing, tregti dhe shërbime LID KOMJUNIKEJSHNS SHPK Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/13 të datës 15.03.2021.

Me shkresën nr. 03-197 të datës 30.03.2021 (Numri ynë PK 09-6/39 i datës 30.03.2021) Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë KAM SHPK Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/18 të datës 15.03.2021.

Me shkresën nr. 004 të datës 05.04.2021 (Numri ynë PK 09-6/40 i datës 07.04.2021) Shoqëria për tregti dhe shërbime IBU MENAXHMENT SHPKNJP Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/17 të datës 15.03.2021.

Me shkresën nr. 18-8292/1 të datës 06.04.2021 (Numri ynë PK 09-6/41 i datës 07.04.2021) HALK BANKA SHA Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/16 të datës 15.03.2021.

Me shkresën PK numër 09-6/42 të datës 11.05.2021 Shoqëria për prodhim, tregti, marketing, propagandë dhe shërbime SKRIN MEDIA eksport – import Zhelinë dorëzoi në KVK plotësim të të dhënave dhe dokumenteve të dorëzuara me shkresën nr. 0302/50-13 të datës 18.03.2021 (Numri ynë 09-6/28 i datës 23.03.2021).

Në seancën e mbajtur më datë 25.05.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/43 ngarkoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me shkresën PK nr. 09-6/44 të datës 25.05.2021 dorëzoi letrën përcjellëse të Konkluzionit PK nr. 09-6/43 të datës 25.05.2021 dorëzuar Shoqërisë për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup.

Në seancën e mbajtur më datë 25.05.2021 KVK Me Konkluzionin PK nr. 09-6/43 ngarkoi Shoqërinë për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me shkresën PK nr. 09-6/44 të datës 25.05.2021 dorëzoi letrën përcjellëse të Konkluzionit PK nr. 09-6/43 të datës 25.05.2021 dorëzuar Shoqërisë për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup.

Me shkresën nr. 01-52 të datës 31.05.2021 (Numri ynë PK 09-6/45 i datës 01.06.2021) Shoqëria për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/43 të datës 25.05.2021.

Me shkresën nr. 166/0302 të datës 09.06.2021 (Numri ynë PK 09-6/46 i datës 09.06.2021) Shoqëria për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/43 të datës 25.05.2021.

Në seancën e mbajtur më datë 15.06.2021 KVK Me Konkluzionin PK nr. 09-6/47 ngarkoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me shkresën PK nr. 09-6/48 të datës 15.06.2021 dorëzoi letrën përcjellëse të Konkluzionit PK nr. 09-6/47 të datës 15.06.2021 dorëzuar Shoqërisë për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup.

Në seancën e mbajtur më datë 15.06.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/49 ngarkoi Shoqërinë për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me shkresën PK nr. 09-6/50 të datës 15.06.2021 dorëzoi letrën përcjellëse të Konkluzionit PK nr. 09-6/49 të datës 15.06.2021 dorëzuar Shoqërisë për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup.

Në seancën e mbajtur më datë 15.06.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/51 ngarkoi Qytetin e Shkupit që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me shkresën PK nr. 09-6/52 të datës 15.06.2021 dorëzoi letrën përcjellëse të Konkluzionit PK nr. 09-6/51 të datës 15.06.2021 dorëzuar Qytetit të Shkupit.

Me shkresën nr. 01-65 të datës 21.06.2021 (Numri ynë PK 09-6/53 i datës 22.06.2021) Shoqëria për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/49 të datës 15.06.2021.

Me shkresën nr. 185/0302 të datës 24.06.2021 (Numri ynë PK 09-6/54 i datës 28.06.2021) Shoqëria për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/47 të datës 15.06.2021.

Me shkresën nr. 13-6004/2 të datës 22.06.2021 (Numri ynë PK 09-6/55 i datës 29.06.2021) Qyteti i Shkupit dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/51 të datës 15.06.2021.

Në seancën e mbajtur më datë 08.07.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/56 ngarkoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

Në seancën e mbajtur më datë 08.07.2021 KVK me Konkluzionin PK nr. 09-6/57 ngarkoi Qytetin e Shkupit që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

Nëpërmjet postës elektronike Shoqëria për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/56 të datës 08.07.2021.

Me shkresën nr. 13-6848/2 të datës 13.07.2021 (Numri ynë PK 09-6/58 i datës 19.07.2021) Qyteti i Shkupit dorëzoi në KVK të dhëna dhe dokumente të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/57 të datës 08.07.2021.

Me shkresën nr. 08-sl të datës 02.09.2021 (Numri ynë PK 09-6/59 i datës 03.09.2021) Qyteti i Shkupit dorëzoi në KVK plotësim të të dhënave dhe dokumenteve të kërkuara me Konkluzionin PK nr. 09-6/57 të datës 08.07.2021.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për shërbime turistike dhe akomodim STONEBRIDGE – HOTEL SHPK Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për tregti dhe shërbime KAN INTERNATIONAL SHPKNJP Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë KAM SHPK Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për tregti dhe shërbime IBU MENAXHMENT SHPKNJP Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për tregti dhe shërbime HALK BANKA SHA Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga TRIGLAV SIGURIMI SHA Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga MAKPETROL Shoqëri aksionare për qarkullim me naftë dhe derivate të naftës Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Qyteti i Shkupit që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria financiare për lëshimin dhe administrimin e kartelave kreditore Diners Club Internacional MAK SHPKNJP Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën PK nr. 09-6/61 të datës 06.12.2021 KVK kërkoi nga Shoqëria për reklamim, marketing, tregti dhe shërbime LID KOMJUNIKEJSHNS SHPK Shkup që të dorëzojë version konfidencial dhe jo-konfidencial të shkresave.

Me shkresën nr. 0204-671 të datës 07.12.2021 (Numri ynë PK 09-6/62 i datës 07.12.2021) Shoqëria për shërbime turistike dhe akomodim STONEBRIDGE – HOTEL SHPK Shkup dorëzoi në KVK përgjigje ndaj shkresës PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021.

Me shkresën PK numër 09-6/63 të datës 10.12.2021 dorëzuar nëpërmjet e-mail adresës TRIGLAV SIGURIMI SHA Shkup dorëzoi në KVK përgjigje ndaj shkresës PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021.

Me shkresën nr. 01-2801/1 të datës 10.12.2021 (Numri ynë PK 09-6/64 i datës 10.12.2021) Shoqëria financiare për lëshimin dhe administrimin e kartelave kreditore Diners Club Internacional MAK SHPKNJP Shkup dorëzoi në KVK përgjigje ndaj shkresës PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021.

Me shkresën nr. 142-01 të datës 10.12.2021 (Numri ynë PK 09-6/65 i datës 10.12.2021) Shoqëria për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup dorëzoi në KVK përgjigje ndaj shkresës PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021.

Me shkresën nr. 03-658 të datës 10.12.2021 (Numri ynë PK 09-6/66 i datës 10.12.2021) Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë KAM SHPK Shkup dorëzoi në KVK përgjigje ndaj shkresës PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021.

Me shkresën Numri ynë PK 09-6/67 të datës 10.12.2021 Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup dorëzoi në KVK përgjigje ndaj shkresës PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021.

Me shkresën nr. 02-12966 të datës 09.12.2021 (Numri ynë PK 09-6/68 i datës 14.12.2021) TRIGLAV SIGURIMI SHA Shkup dorëzoi në KVK përgjigje ndaj shkresës PK nr. 09-6/60 të datës 06.12.2021.

Në seancën e mbajtur më datë 17.12.2022 me Konkluzionin PK nr. 09-14/1 KVK ngarkoi Qytetin e Shkupit që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

Në seancën e mbajtur më datë 17.12.2022 me Konkluzionin PK nr. 09-14/1 KVK ngarkoi Shoqërinë për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

Në seancën e mbajtur më datë 17.12.2022 me Konkluzionin PK nr. 09-14/1 KVK ngarkoi Shoqërinë për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

KVK me letrën përcjellëse PK nr. 09-14/2 të datës 17.02.2022 i dorëzoi Konkluzionet e miratuara në seancën e mbajtur më datë 17.12.2022.

Me shkresën nr. 01-22 të datës 23.02.2022 (Numri ynë PK 09-14/3 i datës 25.02.2022) Shoqëria për marketing dhe pronësi intelektuale MARATON GROUP SHPKNJP Shkup dorëzoi në KVK përgjigje pas Konkluzionit PK nr. 09-14/1 të datës 17.12.2022.

Me shkresën nr. 076/0302 të datës 24.02.2022 (Numri ynë PK 09-14/4 i datës 01.03.2022) Shoqëria për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPK Shkup dorëzoi në KVK përgjigje pas Konkluzionit PK nr. 09-14/1 të datës 17.12.2022.

Me shkresën nr. 027/0302 të datës 22.02.2022 (Numri ynë PK 09-14/5 i datës 01.03.2022) Lid Komjunktejshns SHPK Shkup dorëzoi përgjigje në KVK.

Më datë 03.03.2022 në KVK është dorëzuar një e-mail nga Avokati Vlatko Despodovski si i autorizuar i Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup.

Me shkresën nr. 03-1816/2 të datës 23.02.2022 (Numri ynë PK 09-14/7 i datës 04.03.2022) Qyteti i Shkupit dorëzoi në KVK përgjigje pas Konkluzionit PK nr. 09-14/1 të datës 17.12.2022.

Me shkresën nr. 08-sl të datës 09.03.2022 (Numri ynë PK 09-14/8 i datës 11.03.2022) Qyteti i Shkupit dorëzoi në KVK plotësim pas Konkluzionit PK nr. 09-14/1 të datës 17.12.2022.

Në seancën e mbajtur më datë 20.04.2022 me Konkluzionin PK nr. 09-14/9 KVK ngarkoi Qytetin e Shkupit që të dorëzojë të dhëna dhe dokumente.

Me shkresën nr. 08-4986/1 të datës 29.04.2022 (Numri ynë PK 09-14/11 i datës 04.05.2022) Qyteti i Shkupit dorëzoi në KVK përgjigje pas Konkluzionit PK nr. 09-14/9 të datës 20.04.2022.

Në seancën e mbajtur më datë 08.06.2023 KVK miratoi Njoftim paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-29/1.

KVK me letrën përcjellëse PK nr. 09-29/2 të datës 21.06.2023 dorëzoi Njoftimin paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-29/1 Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup.

Me shkresën PK numër 09-29/3 të datës 04.07.2023 Qyteti i Shkupit dorëzoi në KVK Deklarim pas Njoftimit paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-29/1 të datës 08.06.2023.

Në të njëjtin, Qyteti i Shkupit thekson se ka ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat sipas ligjit i ka në dispozicion me qëllim që kontratën e lidhur me Shoqërinë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup ta shkëpusë, dhe me atë t'i mënjanojë të gjitha pasojat e dëmshme që dalin nga e njëjta në drejtim të çrregullimit të konkurrencës sipas Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Me shkresën PK numër 09-29/4 të datës 07.07.2023 Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup dorëzoi në KVK Deklarim pas Njoftimit paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-29/1 të datës 08.06.2023.

Në seancën e mbajtur më datë 20.09.2024 KVK miratoi Njoftim përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-39/1.

KVK me letrën përcjellëse PK nr. 09-39/2/3 të datës 20.09.2024 dorëzoi Njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-39/1 Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup.

Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup dhe Qyteti i Shkupit në afatin e përcaktuar ligjor nuk u deklaruan pas Njoftimit përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-39/1.

Gjatë procedurës, dhe në bazë të provave të siguruara KVK vërtetoi gjendjen faktike si vijon:

Më datë 21.01.2002 Qyteti i Shkupit dhe Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup kanë lidhur Kontratë nr. 0306-01, lënda e së cilës është rregullimi i të drejtave dhe obligimeve të kontraktuesve për përpunimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të shenjave për orientimin e pjesëmarrësve në komunikacion në Shkup, përkatësisht përpunimin e standardeve dhe normativeve për dukjen e shenjave dhe instalimeve dhe për modalitetet e vendosjes së tyre në korridoret e komunikacionit, pastaj përpunimin e hartës së lokacioneve për vendosjen e shenjave të orientimit, përpunimin e shenjave dhe vendosjen dhe mirëmbajtjen e tyre në kohëzgjatje prej 15 vitesh duke llogaritur pas vendosjes së shenjës së fundit të planifikuar.

Në pajtim me këtë Kontratë, Komiteti i Qytetit për urbanizëm, punë komunale-banesore, komunikacion dhe mbrojtjen e ambientit jetësor ka sjellë Vendim për shfrytëzimin e vendit për reklamim nr. 317/2 të datës 07.07.2005.

Me aktet e lartpërmendura është përcaktuar se:

- Në nenin 1 paragrafi (2) alinea 4) të Kontratës është përcaktuar se kohëzgjatja me të cilën Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup ka të drejtë për vende për shënime për orientim komercial dhe reklamim në periudhë kohore prej 15 vitesh llogaritur pas vendosjes së shenjës së fundit të planifikuar
- Sipas pikave 1 dhe 2 të Vendimit për shfrytëzimin e vendit për reklamim, Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup i janë lëshuar 8128 vende për shënime për orientim komercial dhe reklamim dhe 3939 vende për shënime për orientim dhe njoftim për nevojat e Qytetit të Shkupit, që paraqet numër të

përgjithshëm të të gjitha vendeve të këtij lloji për orientim dhe reklamim që gjenden në territorin e Qytetit të Shkupit.

Sipas nenit 7 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ndalohen të gjitha marrëveshjet e lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe sjelljet e harmonizuara qëllimi ose pasoja e të cilave është çrregullimi i konkurrencës, e veçanërisht ato që e kufizojnë ose e kontrollojnë prodhimin, tregun, zhvillimin teknik ose investimet.

Nga neni i theksuar qartë rezulton se që të ekzistojë marrëveshje e ndaluar ajo duhet të jetë e lidhur ndërmjet dy ndërmarrjeve të pavarura.

Sipas nenit 5 paragrafi (1) alineja 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, "ndërmarrje" është çdo lloj i sipërmarrjes afariste pa marrë parasysh se si është organizuar dhe nga kush udhëhiqet (shoqëri tregtare, tregtar individual, kooperativë, shoqatë e ndërmarrjeve etj.), profesionet e lira (avokatë, mjekë, arkitektë, kontabilistë, noterë etj.), ndërmarrjet publike të themeluara për kryerjen e veprimtarive me interes publik si dhe çdo person tjetër juridik ose fizik, institucion dhe person tjetër juridik dhe fizik i cili ka autorizime publike ose organ i administratës shtetërore që është angazhuar në udhëheqjen e ndonjë aktiviteti ekonomik, pa marrë parasysh se a konsiderohen tregtarë ose jo.

Që një subjekt të konsiderohet ndërmarrje duhet të jetë i angazhuar në udhëheqjen e ndonjë aktiviteti ekonomik, pa marrë parasysh se a konsiderohen tregtarë ose jo. Aktivitet ekonomik, sipas nenit 5 paragrafi (1) alineja 5) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, paraqet qarkullim të mallrave dhe/ose shërbimeve në treg pa marrë parasysh se a është qëllimi i qarkullimit të tillë realizimi i fitimit ose jo.

Sipas Ligjit për Qytetin e Shkupit, Qyteti i Shkupit është i organizuar si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale për kryerjen e punëve publike me rëndësi lokale në kuadër të kompetencës së tij.

Qyteti i Shkupit financohet nga burimet vetanake të të hyrave (tatimet lokale, taksat lokale, kompensimet lokale, të hyrat nga pronësia, të hyrat nga vetëkontributi, të hyrat nga gjobat e përcaktuara me ligj, të hyrat nga donacionet dhe të hyra të tjera të përcaktuara me ligj), të hyrat nga tatimet, të hyrat nga Buxheti i RMV-së dhe buxhetet e fondeve, të hyrat nga huamarrja në pajtim me ligjin dhe nga të hyra të tjera të përcaktuara me ligj.

Sipas nenit 10 pika 1) alineja 5) të Ligjit për Qytetin e Shkupit, kompetenca përkatësisht punë me interes publik me rëndësi lokale të Qytetit të Shkupit janë përcaktimi i standardeve dhe dhënia e pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme, mobilieve dhe pajisjeve urbane në territorin e Qytetit të Shkupit (në rastin konkret përcaktimi i standardeve dhe dhënia e pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme).

Edhe pse në kohën e lidhjes së kontratës kontestuese ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup nuk ka ekzistuar Ligji për koncesione dhe partneritet publik privat (ose ligj tjetër që në mënyrë adekuate e ka rregulluar fushën e koncesioneve dhe partneritetit publik privat), KVK me qëllim që të vërtetojë nëse Qyteti i Shkupit në kontratën kontestuese paraqitet si ndërmarrje ose jo, u udhëhoq edhe nga dispozitat e Ligjit për koncesione dhe partneritet publik privat.

Sipas nenit 4 paragrafi (5) të Ligjit për koncesione dhe partneritet publik privat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 6/2012, 144/2014, 33/2015, 104/2015, 215/2015, 153/2019, 261/2019):

“Partner publik” është person juridik i cili ndan kontratë për themelimin e partneritetit publik privat, edhe atë:

- Republika e Maqedonisë së Veriut,
- komuna, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit,
- ndërmarrjet publike, institucionet publike, shoqëritë tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, komuna, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit dhe shoqëritë mbi të cilat shteti ose organet e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nëpërmjet pronësisë mbi to, përkatësisht zotërojnë pjesën më të madhe të kapitalit të shoqërisë, kanë shumicën e votave të aksionarëve/ortakëve dhe emërojnë më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit drejtues ose mbikëqyrës, përkatësisht organeve të drejtimit të shoqërisë dhe - persona të tjerë juridikë të cilët në pajtim me ligjin kryejnë autorizime publike në pjesën e ushtrimit të autorizimeve publike.

Sipas nenit 4 paragrafi (6) të Ligjit për koncesione dhe partneritet publik privat:

”Koncedent” është subjekti që jep koncesion të të mirave me interes të përgjithshëm, edhe atë:

- Republika e Maqedonisë së Veriut dhe
- komuna, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit.

Sipas nenit 4 paragrafi (7) të Ligjit për koncesione dhe partneritet publik privat:

”Partner privat” është person juridik ose fizik vendas ose i huaj ose konzorcium me të cilin partneri publik lidh kontratë për themelimin e partneritetit publik privat, ose i cili për atë qëllim themelon shoqëri me dedikim të veçantë.

Sipas nenit 5 të Ligjit për koncesione dhe partneritet publik privat:

Partneritet publik privat nënkupton formë të bashkëpunimit të rregulluar me kontratë, afatgjatë ndërmjet partnerit publik dhe partnerit privat, e cila karakterizohet me sa vijon: a) partneri privat e merr përsipër obligimin të sigurojë shërbim publik për shfrytëzuesit fundorë në fushat e kompetencës së partnerit publik dhe/ose obligimin që të sigurojë për partnerin publik parakushte të domosdoshme për dhënien e shërbimit publik për shfrytëzuesit fundorë dhe/ose aktivitete nga kompetenca e tij; b) me qëllim për përmbushjen e obligimeve nga pika a) e këtij paragrafi, partneri privat mund të marrë përsipër obligim të: - financojë, dizajnojë, ndërtojë dhe/ose rikonstruojë/renovojë objekt të infrastrukturës publike, operojë dhe mirëmbajë objekt të ri dhe/ose objekt të rikonstruuar/renovuar të infrastrukturës publike ose - shfrytëzojë, menaxhojë dhe mirëmbajë objekt ekzistues të infrastrukturës publike ose - çfarëdo kombinimi të obligimeve të lartpërmendura përderisa kombinimi i atyre obligimeve është me qëllim për përmbushjen e qëllimeve të vendosura në pikën a) të këtij paragrafi; v) gjatë marrjes përsipër të obligimit nga pikat a) dhe b) të këtij paragrafi, partneri privat zakonisht merr përsipër një pjesë të konsiderueshme të rreziqeve lidhur me financimin, ndërtimin, kërkesën dhe/ose disponueshmërinë dhe veprime të tjera të tilla, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe rreziqet teknike, varësisht nga e dakorduara gjatë themelimit të partneritetit publik privat dhe përcaktohet nga

rasti në rast; g) secili partner në partneritetin publik privat për kohëzgjatjen e partneritetit publik privat do të marrë përsipër përgjegjësi për ngjarje të rrezikshme që janë në sferën e ndikimit të tij, ose përgjegjësia ndahet me qëllim për arritjen e menaxhimit optimal të rrezikut për kohëzgjatjen e partneritetit, ndër të tjera, me shfrytëzimin e aftësive menaxheriale, teknike, financiare dhe inovative të partnerit privat dhe me promovimin e shkëmbimit të shkathhtësive dhe dijes - përvojës ndërmjet partnerit publik dhe privat, pa qenë e njëjta në kundërshtim me pikën v) të këtij paragrafi; d) në këmbim për obligimet e marra përsipër partneri publik mund t'i japë partnerit privat koncesion për punë publike ose koncesion për shërbim publik, ose t'i kompensojë nëpërmjet pagesës; gj) partneri publik, gjithashtu, mund t'i mundësojë partnerit privat të kryejë aktivitete të caktuara ekonomike komerciale, krahas obligimeve nga pikat a) dhe b) të këtij paragrafi, të përcaktuara në kontratë, por vetëm nëse nuk ekziston mënyrë tjetër e mundshme të sigurohet niveli i domosdoshëm i efikasitetit të çmimit të pjesëmarrjes private dhe kthim i arsyeshëm i investimit dhe e) partneri publik mund t'i bartë të drejta të caktuara sendore partnerit privat, të domosdoshme për kryerjen e obligimeve të vendosura me kontratë. Varësisht nga destinimi i mjeteve për kompensim nga ana e partnerit publik për sigurimin e punës publike dhe/ose shërbimit publik, si dhe shpërndarja e rreziqeve kryesore ekzistuese, partneriteti publik privat mund të themelohet si: 1) koncesion për punë publike ose 2) koncesion për shërbim publik ose 3) kontratë për furnizim publik të punës ose 4) kontratë për furnizim publik të shërbimit.

Partneriteti publik privat themelohet me kontratë.

Sipas nenit 3 të kontratës së lidhur ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup nr. 0306-01 të datës 21.01.2002, PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup, të gjitha shpenzimet lidhur me vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të shenjave për orientimin e pjesëmarrësve në komunikacion në Shkup nuk do t'i arkëtojnë nga Qyteti i Shkupit por do t'i kompensojë me të drejtën që instalimet e sistemit të shenjave dhe dritave të shtyllave t'i shfrytëzojë për orientim komercial dhe reklamim.

Nga e theksuara është e qartë se Qyteti i Shkupit me bartjen e obligimit tek PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të shenjave për orientimin e pjesëmarrësve në komunikacion në Shkup kryen bartjen e kompetencës së tij për të cilën në vend që të paguajë kompensim i kompenzon PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup me të drejtën që instalimet e sistemit të shenjave dhe dritave të shtyllave t'i shfrytëzojë për orientim komercial dhe reklamim. Sipas kornizës ligjore të përcaktuar me Ligjin për koncesione dhe partneritet publik privat, KVK vërtetoi se kontrata e lidhur ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup nr. 0306-01 të datës 21.01.2002 paraqet kontratë për partneritet publik privat, në të cilën Qyteti i Shkupit paraqitet si koncedent, ndërsa Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup si partner privat.

Në mënyrë shtesë dhënia e të drejtës për vendosjen e pajisjeve urbane e cila shfrytëzohet për orientim komercial dhe reklamim nga ana e Qytetit të Shkupit nuk paraqet aktivitet ekonomik - nuk paraqet qarkullim të mallrave dhe/ose shërbimeve në treg nga ana e Qytetit të Shkupit, por realizim të kompetencave të tij. Kjo shihet edhe nga fakti se Qyteti i Shkupit këtë kompetencë e realizon nëpërmjet sjelljes së Programit për vendosjen e pajisjeve urbane-panove reklamuese në territorin e Qytetit të Shkupit (si dhe ndryshimeve të tij).

Në bazë të lartpërmendurës, KVK vërtetoi se Qyteti i Shkupit dhe Shoqëria për tregti dhe shërbime PRODUKCIJA PERSPEKTIVA SHPKNJP Shkup **NUK kanë lidhur marrëveshje të ndaluar nga neni 7 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës**, sepse gjatë lidhjes së kontratës nr. 0306-01 të datës 21.01.2002 Qyteti i Shkupit nuk ka vepruar si ndërmarrje, andaj edhe lidhja e kontratës kontestuese **nuk paraqet kundërvajtje nga neni 59 paragrafi (1) pika 1) e në lidhje me nenin 7 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës**.

Për shkak të gjithë kësaj që u theksua më lart KVK vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për inicimin e konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KOMISIONI PËR VENDIMMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE
KRYETAR
Mr. Борче Размоски